



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

DEKLARATA E FORUMIT FEMINIST FemACT 2014

Ne, feministet e reja dhe feministët e rinj, besojmë në barazi gjinore dhe i dimë të drejtat tona që parashesh kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Nëpërmjet kësaj deklaratë ne shprehim rekomandimet tek institucionet e Kosovës, shoqëria civile dhe akterët tjerë për të siguruar të drejtat tona.

Të përfshihen më shumë burra dhe djem në FemACT, dhe në lëvizjen feministe në Kosovë

Barazia gjinore nuk është çështje që u përket vetëm grave dhe vajzave, prandaj për arritjen e barazisë gjinore duhet të përfshihen edhe burrat dhe djemtë. Patriarkalizmi i dëmton burrat dhe djemt duke definuar rolin dhe imponuar sjellje të caktuara në shoqëri. Në këtë mënyrë, ndër të tjera, pengon edhe përfshirjen e tyre në lëvizje feministe. FemACT është i hapur për të gjithë, pa dallim të moshës, gjinisë, etnisë, apo fesë. FemACT paraqet një platformë ku feministet e reja dhe feministët e rinj mund të ndajnë informata, dhe të organizojnë aksione publike.

Kërkojmë nga organizatat e shoqërisë civile, që mirren me çështje të barazisë gjinore dhe e konsiderojnë vetën feminist, që kur flitet dhe veprohet për arritjen e barazisë gjinore të përfshijnë edhe burrat dhe djemt. Në këtë mënyrë do t'ju hapet rruga burrave dhe djemve që të jenë pjesë e lëvizjes feministe në Kosovë.

Të rishikohen kurrikulat mësimore nëpër shkolla dhe universitete me qëllim të eliminimit të gjuhës seksiste, paragjyqimeve dhe stereotipeve gjinore

Tekstetet shkollore parauniversitare vazhdojnë të jenë me përmbajtje stereotipe gjinore, gjë që ndikon në krijimin e profesioneve të stereotipizuara dhe krijimin e botëkuptimeve tradicionale ndaj roleve gjinore. Në të njëjtën kohë, për tekstet univesitare nuk ka hulumtime dhe përfshirje gjinore.

Ne kërkojmë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të bëjë rishikimin e teksteve shkollore parauniversitare dhe të ndërmarrë masa për eliminimin e përmbajtjeve stereotipe gjinore nga këto tekste shkollore. Gjithashtu, kërkojmë nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", që në arsimin e lartë të realizohet një hulumtim gjithëpërfshirës mbi tekstet universitare, të krijohet strategjia gjinore mbi përfshirjen gjinore në tekstet universitare si dhe të krijohet komisioni mbi vlerësimin e teksteve gjinore para botimit.

Të vendosen politika dhe procedura më të mira për raportimin dhe adresimin e ngacmimit seksual, me theks të veçantë në hapësira publike

Ngacmimi seksual në vendin e punës, shkollat, universitetet, si dhe institucionet publike është raportuar te RrGGK. Një studim i Qendrës për Studime Gjinore të Kosovës i 2010 gjeti se 16.6% e nëpunësve civilë kishin përjetuar ngacmime seksuale të paktën një herë gjatë karrierës së tyre.¹ Fokus grupet që janë mbajtur në Universitetin e Prishtinës kanë sugjeruar se ngacmimi seksual është me sa duket i përhapur, por jo i raportuar sa duhet. Edhe kur është raportuar, është injoruar. Ligji Kundër Diskriminimit ndalon diskriminimin dhe ngacmimet, duke përfshirë sjelljen e padëshiruar seksuale dhe psikologjike që shkel

¹ Demolli, Luljeta për QKSGJ, *Perceptimet e shërbyesve civilë Lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës, Prishtinë: QKSGJ, 2010, f. 10.*

dinjitetin e një personi.² Më tutje, Ligji për Barazi Gjinore thekson se ngacmimi seksual përbën diskriminim.³

Ne kërkojmë nga institucionet relevante të Kosovës që të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe akterët tjerë në vënien në vend të politikave dhe procedurave të nevojshme për adresimin e ngacmimit seksual, si dhe në drejtim të instalimit të mekanizmave të përmirësuar për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual.

Të ndalohet personifikimi i grave dhe vajzave si objekt seksual në media

Gazetaria kosovare duhet të mbërthejë në vete principet e barazise gjinore, duke filluar që nga mënyra se si paraqiten dhe përshkruhen gratë dhe vajzat në mediat tona. Paraqitja dhe përshkrimi jo i barabartë dhe raportimi jo-etik mbi gra dhe vajza ka efekte negative në besimin e opinionit të gjërë në media. Për më shumë, ato përforcojnë stereotipe shoqërore mbi rolet gjinore.

Ne kërkojmë nga Komisioni i Pavarur për Media, përgjegjës për mediat elektronike, dhe Këshilli i Mediave të Shkruara, përgjegjëse për gazetat e shtypura dhe ato online, të ndalojnë personifikimin e grave dhe vajzave si objekt seksual, si dhe të shtyjnë tutje denimet atëherë kur paraqiten raste të tilla.

Prishtinë, Kosovë

29 nëntor deri me 1 dhjetor 2014

² Kuvendi i Kosovës dhe UNMIK-ut, *Ligji Kundër - Diskriminimit*, Ligji nr. 2004/3.

³ Kuvendi i Kosovës dhe UNMIK-ut, *Ligji për Barazi Gjinore*, Ligji nr. 2004/2.